

**NE EMER TE POPULLIT**

*Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme Emine Salihu, me ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarës M. S., nga Prishtina, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 të KPRK-së, të cilën e mbron Av.Arsim Vranovci, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.382/2020, të datës 20.05.2020, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Humë Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e prokurorit të shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, më 23.11.2020, publikisht shpalli këtë,*

**A K T G J Y K I M**

*E pandehura M. S., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati ...., dhe e ëma ...., mbiemri i vajzërisë ....., e lindur më ....., në Prishtinë, ku edhe jeton në Lagjen “.....”, Rr.”.....”, p.nr. e pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, e papunë, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, e pa dënuar deri më tani, për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale,*

**Është fajtor**

*Sepse, më datë 06.03.2020, rreth orës 23.30min, në hyrje të Fsh.Parallovë, duke e drejtuar automjetin e markës VW “Golf” AU, me tabela të regjistrimit 01-629-NM, ne relacioin Gjilan-Prishtinë, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik rreshpektivisht jetën e njerzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që me të arritur në vendin e cekur, duke hyrë në një kthesë, nuk ia ka përshtatur shpejtësinë ngasjes së automjetit, kushteve të rrugës( kthesë e thellë në të djathtë dhe asfalt i lagur) dhe duke zhvilluar shpejtësinë prej 87 km/h, ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 par.2 dhe nenin 53 par.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor të Kosovës, ashtu që gjatë kalimit në kthesë ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit duke kaluar në shiritin e majtë të rrugës, ku me qrast në pjesën e parë të anës së majtë të automjetit të saj godet automjetin e markës “Golf Au”, me tabelë regjistrimi 01-206-LR, të cilin në ato qaste ka qenë duke e drejtuar tani i dëmtuari G. L., nga Gjilani, ku me këtë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore A. B., nga Prishtina e cila është dërguar për trajtim mjekesor në QKUK, në Prishtinë, e cila nuk ka mundur ti mbijetojë plagëve dhe ka nderruar jetë me datë 18.03.2020, ndërsa lëndime të lehta trupore në këtë rast kane pësuar D. N., dhe T. G., nga Prishtina si dhe V. B. nga Hajvalia, të cilët kanë qenë në automjetin e të pandehurës si dhe vozitësi i automjetit tjetër G. L., si dhe është shkaktuar dëm material ne vlerën e papërcaktuar në veturën e tij.*

*Me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 370 paragrafi 9 të KPRK-së,*

*Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39, 46, 47, 48, 49, 50, 52, 59, 64, 69, 71, të KPRK-së, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit, i shqipton:*

### **E G J Y K O N**

*Me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 vite, të cilin dënim e akuzuara nuk do ta mban, në qoftë se në afat prej 3 vite, nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , në të kundërshton dënimi me kusht do të revokohet, si dhe me*

*Dënim plotësues Ndalimi i drejtimit te automjetit*

*Të dëmtuarit G. L., nga Gjilani, Rr”.....”, nr.42, V. B., nga Hajvalia, T. G., nga Prishtina, dhe D. N., nga Prishtina, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil*

*E akuzuara obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 25 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcënim te përmbarimit të dhunshëm.*

*Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit e pandehura M. S., obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur akuzën , PP.II.nr.382/2020 të datës 20.05.2020, kundër të akuzuarës M. S., , nga Prishtina, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 të KPRK-së.*

*Prokurorja e shtetit Humë Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 23.11.2020, deklaroj: se nuk e kundërshtoj pranimin e fajesisë nga ana e të akuzuarës, si dhe i propozoj gjykatës që të shqiptohet edhe dënimi plotësues ashtu si është propozuar në aktakuzë dhe atë ndalimi i drejtimit të automjetit konform nenit 64 par.1 dhe 2 të KPPK-së, dhe propozoj që ky propozim të aprovohet.*

*Mbrojtësi i të akuzuarës Av.Arsim Vranovci, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 23.11.2020, deklaroj: M. nuk është një person që ka bërë vepër penale e dashje, kjo që ka ndodhur ka ndodhur.M. ndien shumë dhembje për një shoqe që e ka humbur dhe deklaron që ajo që është bërë M., do ta përcjellë dhe gjendja e saj dhe shëndeti tërë jetën do të ketë pasojë prej kësaj vepre. Pranimin e fajësise e pandehura e pranon pa kurfarë dhune dhe presioni, vullnetarisht , në bashkëpunim me mua.*

*E pandehura M. S., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 23.11.2020, ka deklaruar : se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores së shtetit e kam kuptuar në tërësi ,e ndiej vehtën fajtor dhe e pranoj fajsinë, është hera e parë që ndeshem me*

ligjin, i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë. Kjo vepër penale është kryer pa dashjen time dh pa kurfarë qëllimi, kjo ka ndodhur rastësisht nga pakujdesia dhe kushtete këqija atmosferike.Me palën e dëmtuar nuk kemi kurfarë mosmarveshje, jemi pajtuar, e që prindi i tani të ndjerës Arbnora, në prokurori e edhe tani ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj meje dhe gjithqka është në rregull.

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit, të akuzuarës dhe mbrojtësit të të akuzuarës, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajsisë ,nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë ,gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se e pendehura M. S., nga Prishtina, e ka kryer veprën penale Vozitje në gjendje te paaftë dhe të dehur nga neni 370 par.9 të KPRK-së,

Gjyqëtarja e vetme gjykuese, shpalli fajtores të pandehurën M. S., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurës gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë ,sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqëardheje për kryerjen e kësaj vepre , është penduar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale . Ndërsa , nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate ,caktimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurës M. S., është dënim i drejtë ,në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË  
Departamenti i përgjithshëm

*P.nr.40/2020  
Më:23.11.2020*

*Ref. e lartë  
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja  
Emine Salihu*

*KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimet të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.*